



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. _____/2018

Data: 24.08.2018

PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e gjashtë -VI- për vitin 2018 e Komitetit për Politik dhe Financa, mbajtur me datë 22.08.2018 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Fari Kalisi (Drejtor për Administratë), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Sevime Laçi (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Bashkim Sopa (Zyrtar për transparencë), Irfan Suma (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Abil Thaçi (Kryesues i komisionit të aksionarëve të N.P.L “Pastrimi” sh.a), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politik dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i raportit të punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2018.
3. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Qershor 2018.
4. Shqyrtimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoha komunale për vitin 2019.
5. Shqyrtimi i informatës mbi Qarkoren e dytë të brendshme buxhetore.
6. Shqyrtimi i informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2017-2018.
7. Shqyrtimi i informatës mbi raportin e shpenzimeve për "Javën Kulturore" 2018.
8. Shqyrtimi i informatës për korrje shirjet.
9. Shqyrtimi i informatës për raportin financiar për periudhën Janar -Qershor 2018 të N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- përveç pikave të rendit të punës ndërkohë me një ankesë më është drejtuar z.Brahim dhe Sinan Curri dhe këtë ankesë e kam parë të arsyeshme me diskutuar në KPF. Nëse jeni të mendimit mundemi me proceduar për kuvend.

Akif Shkreta thekson:- si KPF nuk e kemi të drejtën me ndërpre dhe në kuvend pse me marr përgjegjësinë që me ua mohuar të drejtën këtij dhe qytetarëve të tjerë që parashetrojnë kërkesat apo qoftë edhe ankesat. Ne e procedojmë për kuvend dhe kërkojmë mendimin e drejtorisë përgjegjëse. Kjo ankesë nuk e di a është shqyrtuar edhe në ekzekutiv sepse nëse lihet që çdo qytetarë me bërë ankesë në kuvendë bëhen afër 20 pika të rendit të punës, andaj mendoj që është një kërkesë që nuk është në kompetencë të kuvendit të komunës.

Mehmet Ballazhi thekson:- është mirë që drejtori të na jep një sqarim të shkurtë sepse ankesën e lexova dhe i pashë arsyet e ankesës dhe kërkesën që ka parashtruar dy herë pastaj edhe përgjigjen e dhënë nga drejtorja përgjegjëse. Si komitet për politik e financa e procedojmë për kuvendë dhe në kuvend e diskutojmë .

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për pikën shtesë të rendit të punës; nëse nuk ka e hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës ; rezultati i votimit ishte njëzëri, (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

MIRATOHET RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i raportit të punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2018.
3. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Qershor 2018.
4. Shqyrtimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2019.
5. Shqyrtimi i informatës mbi Qarkoren e dytë të brendshme buxhetore.
6. Shqyrtimi i informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2017-2018.
7. Shqyrtimi i informatës mbi raportin e shpenzimeve për "Javën Kulturore" 2018.
8. Shqyrtimi i informatës për korrje shirjet.
9. Shqyrtimi i informatës për raportin financiar për periudhën Janar -Qershor 2018 të N.P.L “Pastrimi” sh.a.
10. Shqyrtimi i ankesës së z.Brahim dhe Sinan Curri.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutim,

Shabi Rexhallari thekson:- te prezenca e ekzekutivit ne të shënohet edhe emri imë që isha në mbledhje. Faqe tre te diskutimi imë në vend të fjalës brenda dy dite, të zëvendësohet dhe të jetë brenda dy dite.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë vërejtje nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i raportit të punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- në raport janë prezantuar aktivitetet e ekzekutivit të komunës për periudhën gjashtë mujore të vitit 2018. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Akif Shkreta thekson:- te raporti ka disa gabime dhe është mirë të përmirësohen.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2018 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

3. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Qershor 2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- të hyrat vetanake kanë shënuar trendë rritëse prej rreth 20% që korrespondon me 27000 € më shumë krahasuar me gjashtëmujorin e vitit paraprak. Kjo rritje ka ardhur në masë të madhe nga të hyrat e tatimit në pronë, si dhe nga të hyrat indirekte (të hyrat e dënimeve në trafik). Shpenzimet buxhetore kanë arritur në 897 mijë euro përgjatë periudhës gjashtëmujore të vitit 2018, apo 9% më shumë krahasuar me shpenzimet e krahasuara gjatë të njëjtës periudhë të vitit paraprak. Kjo rritje është nxituar nga ekzekutimi më i lartë nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, të cilat janë rritur me 100% krahasuar me vitin paraprak, të pasuar me kategorinë subvencione dhe transfere me 29.82%, një rritje nga kategoria e pagave dhe mëditjeve me 5% si rezultat i rritjes së pagave për të gjithë shërbyesit civil që marrin pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës, ndërsa dy kategoritë tjera ajo e shpenzimeve komunale dhe e investimeve kapitale kemi një rënie prej -1% kundrejt -7.25%. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-qershor 2018 është në shumë prej 897,238.40 € apo 30.43 %. Prej tyre për paga dhe mëditje janë shpenzuar 719,400.65 € apo 49.81 %, për mallra dhe shërbime 79,585.70 € apo 34.65 %, për shpenzime komunale 21,381.15 € apo 48.01 %, për subvencione dhe transfere 29,635.80 € apo 56.13 % dhe për shpenzime kapitale 47,235.10 € apo 4.01%. materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo propozim mund të parashtroni.

Nora Xhoni thekson:- te të hyrat vetanake në krahasim me vitin e kaluar ka një rritje dhe çka ka ndikuar që për këtë periudhë të kemi më shumë të hyra.

Akif Shkreta thekson:- brenda këtij gjashtë mujori potencohet se është realizuar 30 % e buxhetit kurse i kemi edhe gjashtë muaj deri në fund të vitit dhe kemi 70 % të buxhetit të pa realizuar. A do të ishte mirë që brenda gjashtë mujorit të realizohet 50 % e buxhetit dhe në gjashtë mujorin e ardhshëm të realizohet edhe 50 % e buxhetit.

Mehmet Ballazhi thekson:- a është një rritje që ju keni gjet një metodë për me i inkasuar këto tatime apo janë të viteve të kaluar dhe tash e kanë rritë këtë shumë të të hyrave vetanake.

Shabi Rexhallari thekson:- te rritja e të hyrave te tatimi në pronë kemi bërë përpjekje përmes njoftimeve për tatim paguesit të cilët kanë borxhe . Afër 60 njoftime i kemi shpërndarë si vërejtje dhe tatim paguesit ju kanë përgjigjur ftesës. Të hyrat nga kategoritë e tjera janë njëjtë sikur viti e kaluar me përjashtim të hyrat nga dënimet. Sa i përket shpenzimit në përqindje po që se marrim periudhën gjashtë mujore të viti të kaluar është në shumë 32 % që do të thotë se është e njëjtë si përqindje, kurse nëse krahasohet si shumë në këtë vit kemi 77 000 € shpenzim më tepër se vitin e kaluar. Në muajin janar nuk mund të fillohet me asnjë procedurë për shkak se nuk ka mjete financiare dhe të gjitha procedurat kanë filluar në muajin shkurt.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri, (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA RAPORTI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2018 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

4. Shqyrtimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- kjo është një rregullore që për çdo vit shqyrtohet dhe miratohet në kuvendë. Kemi bërë disa propozime për ndryshime ju i keni të hijezuara dhe nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- në mbledhje të më hershme të kuvendit është diskutuar që të hiqet taksa në shumë prej 10 € për regjistrim të automjeteve. Këtë çështje e parashtrova për shkak se qytetarët më janë drejtuar dhe kërkojnë që kjo taksë të zbritet apo nëse janë mundësitë ligjore me u heqë krejt.

Akif Shkreta thekson:- me sa jam në dioni kjo taksë është si mekanizëm kushtëzues për me i kryer tatimin në pronë dhe në çoftë se do të merret vendim për largimin e kësaj takse kush do ta paguan tatimin në pronë.

Mallzum Qajani thekson:- kjo taksë në shumë prej 10 € nuk është një rëndesë e madhe për qytetarët e komunës së Hanit të Elezit. Është e vërtetë që nuk inkasojmë ne mjete që do të ndikonte drejtë për drejtë në buxhet dhe ndikon në mënyrë indirekte në inkasimin e të hyrave vetanake sepse nëse si qytetarë vendos me regjistruar një veturë dhe nuk e ke të kryer obligimin e tatimit në pronë dhe duhesh ta paguash tatimin në pronë për me marr taksën për regjistrimin e veturës.

Mehmet Ballazhi thekson:- duhet të shikohen mundësitë që me një vërtetim për me bërë kushtëzimin e jo përmes taksës për regjistrim të veturave për shkak se nuk mundesh me një taksë në shumë prej 10 € me i mbuluar borxhet e tjera.

Mallzum Qajani thekson:- në çoftë se qytetari ka mundësi me pas veturë ka mundësi me paguar edhe tatimin në pronë dhe obligimet e tjera ndaj komunës. Ne mundë të diskutojmë për me ulë këtë por nuk mund ta heqim krejt.

Shabi Rexhallari thekson:- kjo taksë është e përcaktuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale por nuk është e përcaktuar si tarifë. Asnjë komunë nuk e ka hequr këtë taksë dhe nëse hiqet kjo taksë qytetarët nuk do ta paguanjë tatimin në pronë dhe taksën në biznes.

Mehmet Ballazhi thekson:- drejtori e potencojë që nuk është e përcaktuar tarifa por duhet të shikohen mundësitë dhe të jetë një pagesë shumë minimale te kjo taksë sepse qytetarët po e paguanjë tatimin në pronë.

Kryesuesi thekson:- si ekzekutiv a jeni interesuar që me pas taksë mbi ndotjen e ambientit për shkak se ndotësi më i madh është kompania “Sharrcem”.

Akif Shkreta thekson:- taks për ndotje nuk ka por ka ligj të veçantë për ndotje dhe komuna e Hanit të Elezit nuk ka hyjë me ligj të veçantë dhe mundësit janë që përmes nivelit qendrorë me bërë që edhe Hani i Elezit me u trajtuar me ligj të veçantë për shkak të ndotjes.

Sevime Laçi thekson:- çështjen e taksës e kemi biseduar por nuk e parashih Ligji.

Mehmet Ballazhi thekson:- kompanisë “Sharrcem” me ja ngritë taksën e mos me ndal ndotjen nuk kemi bërë diçka por më mirë është që të bisedojmë dhe t’i bëhet presion për mos me ndotë ambientin.

Akif Shkreta thekson:- në mbledhje të kuvendit është miratuar një rezolutë dhe e kemi mbështetë. U propozua që të riformohet një komision i kuvendit dhe atij komisioni t’i bashkëngjitet një përfaqësues i ekzekutivit. Komisioni të takohet me bordin e kompanisë “Sharrcem”. Matësi i cili është i vendosur te shkolla fillore nuk është duke e bërë matjen e saktë të ndotjes së ambientit për shkak se ka qytetarë që e kanë matë përmes telefonit dhe ka dal shumë keq ndotja e ambientit në komunën tonë . Komisioni të zhvillon negociata me përfaqësuesit e kompanisë “Sharrcem” dhe t’i jep një afat dhe nëse kalon kjo ne duhet t’i mobilizojmë qytetarët sepse qytetarët po i akuzojnë institucionet, e jo të merret me kërcënime kompania “Sharrcem” se gjoja do t’i largon punëtorët nga puna që do të thotë që kjo është një lloj shantazhe.

Mehmet Ballazhi thekson:- në kuvend e kemi kërkuar që të bëhet ndërrimi i lokacionit të matësit të ndotjes së ambientit dhe nuk e di ekzekutivi a e ka kërkuar këtë çështje. U potencua që është miratuar një rezolutë dhe ju si propozues duhet të shikoni se si është duke shkuar rrjedha e rezolutës.

Nexhmedin Daci thekson:- ne e kemi qasjen e gabueshme ndaj “Sharrcemit” sepse potencojmë se vetëm “Sharceci” është ndotës dhe asgjë nuk ka bërë. Nuk ka kurrfarë teknologjie në botë që ndotjen e ndalë qind për qind por mund ta redukton me standarde . Rregullisht kam pas kontakte me përfaqësuesit përgjegjës për çështje te stacionit për monitorimin e ajrit por është problem lokacionin ku me gjet për shkak se nuk mundemi me vendosë stacionin për monitorimin e ajrit afër kompanisë “Sharrcem” për shkak se vetëm ndikimin e kompanisë “Sharrcem” e matë. Lokacioni më i përshtatshëm për mendimin tim është te prona e z.Hasan Vila. Kompania “Sharrcem” ka filluar për mbylljen e anës jugore dhe veriore të hallës së klinkerit. Ne duhet të intervenojmë te përdorimi i materialeve që i bënë kompania “Sharrcem” te piriti për shkak se është i dëmshëm dhe mbahet në hapësira të hapura dhe ndonjë herë kundërmon erë e rëndë. Investime kanë bërë në përmirësim të ndotjes së ajrit.

Medina Imishti thekson:- pëlqimet që bëhen për hapje të objekteve dhe inspektoret i kërkohet prej Ministrisë që të lëshon një pëlqim sanitarë dhe kemi menduar të jetë 20 €.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri, (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA RREGULLORJA PËR TAKSA TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Shqyrtimi i informatës mbi Qarkoren e dytë të brendshme buxhetore.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- për vitin 2019 në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje buxheti do të jetë në shumë prej 1,493,148 €, në mallra dhe shërbime 238,467 €, shpenzime komunale 54,400 €, subvencione dhe transfere 61,104 € dhe shpenzime kapitale 1,042,565 €. Për vitin 2019 të gjitha kategoritë kanë ngritje.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA INFORMATA MBI QARKOREN E DYTË BUXHETORE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Shqyrtimi i informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2017-2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson:- materiali është dërguar me kohë dhe jemi munduar në mënyrë të qartë t'i paraqesim të dhënat.

Akif Shkreta thekson:- shënon se për 13 nxënës është zvogëluar numri dhe në krahasim me komutat e tjera nuk është një numër i madh. Te tabela katër është vetëm emri i shkollës por nuk figuron emri. Planet zhvillimore të shkollave me një dërguar neve si këshilltarë për shkak se harmonizohen edhe projektet e tona. Është mirë që të njoftohet kuvendi se çka kanë të planifikuar shkolla për tri vitet e ardhshme.

Mehmet Ballazhi thekson:- nuk është një vetëdije e kënaqshme e nxënësve por edhe atij trekëndëshi didaktik për shkak se nuk funksionon. Është mirë që këtë trekëndësh me futë në funksion sepse dy apo tri raste i kam pas që jam munduar me aplikuar dhe ka ndikuar pozitivisht te fëmija.

Menduh Vlasi thekson:- në takim me drejtorët e shkollave do tu a përcjelli dhe do të mundohemi me funksionuar trekëndëshin didaktik.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA INFORMATA MBI SUKSESIN E ARRITUR TË NXËNËSVE NË SHFMU DHE SHML NË FUND TË GJYSMËVJETORIT TË DYTË TË VITIT SHKOLLORË 2017-2018 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Shqyrtimi i informatës mbi raportin e shpenzimeve për "Javën Kulturore" 2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- në informatë janë të shënuar të gjitha shpenzimet që janë bërë për javën kulturore. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- më herët kam kërkuar që të ndahet buxheti për kulturë ri në mënyrë që mos të kemi problem për shpenzim të mjeteve financiare për javën kulturore për shkak se nuk kemi informacion për mjetet e mbetura se ku do të shpenzohen.

Menduh Vlasi thekson:- në planifikimet buxhetore për vitin 2019 do t'i planifikoj mjetet financiare për të gjitha aktivitetet kulturore që do t'i planifikojmë me i mbajt për vitin 2019. Mjetet financiare që kanë mbetur pa u shpenzuar janë nga kategoria mallra dhe shërbime dhe do të shfrytëzohen dhe në fund raportohen se ku janë shpenzuar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA VOTU INFORMATA MBI RAPORTIN E SHPENZIMEVE PËR "JAVËN KULTURORE" 2018 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Shqyrtimi i informatës për korrje shirjet.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- materialet janë paraqitur në pika të shkurtra dhe nëse keni ndonjë pyetje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- a është bërë një krahasim me vitin e kaluar. Është mirë me gjet ndonjë mundësi për me i subvencionuar.

Zaim Bela thekson:- vitin e kaluar ishin 28 hektarë kurse tash afër 14 hektarë. Jemi munduar me i subvencionuar por është në rënie për shkak se ata të cilët po mbjellin më tepër po i bëjnë shpenzimet dhe komuna nuk po ka mundësi më shumë me i subvencionuar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA INFORMATATA PËR KORRJE SHIREJ QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

9. Shqyrtimi i informatës për raportin financiar për periudhën Janar -Qershor 2018 të N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abil Thaçi thekson:- në periudhën gjashtë mujore të vitit 2018 kompania ka pas të hyra në shumë prej 39,976.00 € , kurse shpenzime financiare ka pas në shumë prej 35,956.00 €. Gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar 89 kontrata te reja dhe 3 kontrata biznese. Kompania ka nënshkruar marrëveshje me komunën e Hanit të Elezit për furnizim me derivate të naftës.

Mehmet Ballazhi thekson:- është mirë të shikohen mundësit financiare për sanimin e defektit për shkak se kamioni po rrjedhë dhe kundërmon erë e rëndë. A ka ende qytetarë të cilët nuk i nënshkruajn kontratat dhe pse hezitojnë sepse ata i hedhin diku mbeturinat.

Refet Kalisi thekson:- kamioni i ri nuk e ka atë problem sikur ka qenë i vjetri dhe është mirë që rezervarin me zbraz diku tjetër.

Abil Thaçi thekson:- ka ende pa nënshkruar për shkak të shtrirjes së kompanisë edhe në disa fshatra, kurse për ato fshatra që kompania ka shtrirje dhe qytetarët të cilët nuk janë pajisur me kontrata do të interesohemi.

Akif Shkreta thekson:- në disa fshatar ka persona që nuk janë përfshirë dhe janë raste sociale dhe komuna duhet t'i ndihmon sepse ka qytetarë në fshatin Seçishtë që nuk janë përfshirë dhe mbeturinat i hedhin në prrockë. Këto raste duhet të identifikohen dhe të bëhet një zgjidhje. Problem po kemi me mbeturinat e ngurta që duhet të xhindet një vend se ku me i hedhë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA INFORMATATA PËR RAPORTIN FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2018 TË NPL PASTRIMI SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

10. Shqyrtimi i ankesës së z.Brahim dhe Sinan Curri.

Kryesuesi thekson:- për mbledhje të kuvendit të komunës të gjitha materialet që i ka drejtorja përkatëse për këtë pikë të rendit të punës me najë dërguar për shkak se nuk kemi informacione. Prona për të cilën flitet a është pronë komunale. Ndërtimi i përkohshëm a ka leje komunale. Me parashtruesin e ankesës kam pas takim dy herë dhe i kam potencuar se nuk është në kompetencë të kuvendit dhe përsëri mendoj që nuk është në kompetencë të kuvendit. Nëse është ndonjë interes komunal me ligj janë të përcaktuara mënyrat. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- unë mendoj që të përcillet për kuvendë sepse duhet të sqarohet për shkak se ne po i përfaqësojmë qytetarët dhe sqarimet në kuvend mendoj se janë të domosdoshme.

Nexhmedin Daci thekson:- rastin e kemi trajtuar mirë sepse në afat ligjor ju kemi përgjigjur. Ka parashtuar ankesë në Ministri dhe për këtë çështje ishin tre inspektorë me të cilët kemi dal në teren dhe e kanë parë gjendjen. Ministria është përgjigjur dhe nuk ka potencuar që duhet me rrënuar objektin. Kur është hartuar plani zhvillimorë dhe planet e tjera është diskutuar edhe çështja e këtyre lokaleve afariste sepse asnjëra nuk i plotëson standardet për shkak se janë dhënë në vitet e tetëdhjeta nga komuna e Kaçanikut dhe në atë kohë Hani i Elezit nuk ka pas plan. Kur është diskutuar rreth planeve ka qenë një qëndrim i joni që lokalet afariste qysh të ndodhin ndërtimet e reja me plan këto me u prishë dhe shembull konkret e keni z.Emrush Suma i cili ka bërë ndërtim.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA ANKESA E z.BRAHIM DHE SINAN CURRI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30 ju faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava
